



VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC

P.nr.1980/12

NË EMËR TË POPULLIT

30 - 42 - 2015

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGGJITHSHËM - Divizioni penal, si gjykatë e shkallës së parë penale në përbërje nga gjyqtari I netëm gjykues, Hysnije Gashi me pjesëmarrjen e sek juridike, Geniana Hoxha punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të pandehurve , [REDACTED] , [REDACTED] , [REDACTED] , për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga nen. 153 par 2 lidhur me par 1 nën par.4 të KPK-së, sipas propozim akuzës së PPK -së në Ferizaj PP nr.1448-03/12 të dt.17.12.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në praninë e prokurorit të shtetit, dhe të pandehurve , më dt. 09.11.2015 të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### AKTGJYKIM

1. I pandehuri [REDACTED] Ferizaj, rr. [REDACTED], nr. [REDACTED] i lindur më [REDACTED] në Ferizaj, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], i martuar baba i katër fëmijëve, punëtor në ndërtimtari , i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. I pandehuri [REDACTED], Ferizaj, rr [REDACTED] pa nr. [REDACTED] i lindur më [REDACTED], në Ferizaj nga i ati [REDACTED] e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], i martuar baba i tre fëmijëve, punëtor në ndërtimtari , i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës.

3. I pandehuri [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna Ferizaj, i lindur më [REDACTED] në fsh [REDACTED] nga i ati [REDACTED], e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] i martuar, baba i tre fëmijëve, pronar i marketit NTP [REDACTED] i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës.

4 [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna Ferizaj , i lindur me [REDACTED] në fshatin [REDACTED], nga i ati [REDACTED] e ëma Manushe e gjinisë [REDACTED] punëtor në marketin [REDACTED], shtetas i Republikës së Kosovës , i gjendjes së mesme ekonomike.

## JANË FAJTORË

### I.

1. [REDACTED]

2. [REDACTED]

Sepse me dt24.08.2012 , rreth orës 20.00, në fshatin Bibaj, komuna Ferizaj, në bashkëkryerje kan sulmuar të dëmtuarin [REDACTED] në atë mënyrë që pas një mosmarvëshje fillimisht në mes të pandehurit [REDACTED] dhe pronarit të kafiterisë [REDACTED] – të pandehurit [REDACTED] lidhur me pagesën e pijeve të pandehurit arrin te kafiteria dhe me mjete të forta shkopinj druri e gogasin të dëmtuarin [REDACTED] në kokë dhe pjesë të ndryshme të trupit me ç'rast i shkaktojnë lëndime të lehta trupore dhe atë plagë mbretëse në ballë, konfuzione në kokë si dhe thyerje të eshtrave të hundës të cilat lëndime rezultojnë me pasoja të përkohshme të shëndetit.

**-me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par. 1 nën par 4 dhe 23 të KPK-së.**

### II.

3. [REDACTED]

4. [REDACTED]

Me datën 24.08.2012, rreth 20.00, në fshatin Bibaj komuna Ferizaj në bashkëkryerje ka sulmuar fizikisht të dëmtuarit [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] në atë mënyrë që mënyre që deri sa ishin në kafi terin e tyre pas një mosmarrëveshje fillimisht në mes të pandehurit [REDACTED] lidhur me pagesën e pijeve , aty fillon kacafytja ku më vonë vinë edhe të dëmtuarit [REDACTED] dhe [REDACTED] në atë qast të pandehurit më mjete të forta

karrige i godasin në pjesë të ndryshme te trupit me ç' rast të dëmtuarit pësojnë lëndime të lehta trupore dhe atë: [REDAKTUAR] plagë mbetëse në murorin e kokës dhe parakrahun e sipërm, [REDAKTUAR] plagë mbetëse në pjesën muore të kokës dhe parakrahun e majtë, të cilat lëndime rezultojnë më dëmtrim të përkohshëm të shëndetit

**me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par. 1 nën par 4 dhe 23 të KPK-së.**

Gjykata në bazë të nenit 3,6, 15, 34, 41, 42, 43, dhe 64 të KPK-së, dhe nen.365 të KPPK-së, e

## GJYKON

### DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit:

1. [REDAKTUAR] †
2. [REDAKTUAR]
3. [REDAKTUAR]
4. [REDAKTUAR] †

Të Akuzuarin [REDAKTUAR]

**ME DËNIM BURGIMI** në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse I pandehuri në afatin prej një viti nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Të akuzuarit :

1. [REDAKTUAR]
2. [REDAKTUAR]
3. [REDAKTUAR]

**ME DËNIM BURGIMI** në kohëzgjatje prej 4 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të pandehuri t në afatin prej një viti nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

**I Dëmtuari** [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohent të akuzuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] që secili veq e veq në emër të paushallit gjyqsor të paguaj kësaj gjykate shumën prej 30/tridhjet / Euro, dhe në emër të shpenzimëve të procedurël penale në shumën prej 25 € të gjitha në afatin prej 15 ditësh pas plotëfuqishmëris së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria publike Komunale në Ferizaj me propozim akuzën PP nr. 1448-03/12 të dt. 17 dhjetor 2012 ka ngarkuar të pandehurit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] për vepër penale lëndim i lehtë trupor nga nen. 153 par.2 lidhur me par.1 nën par 4 dhe 23 të KPK.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me dt.09.11.2015 në të cilën përf.i akuzës – prokurori I shtetit Visar Musa, lexoj aktin akuzues dhe gjyqtari pasi u bind se të pandehurit kanë kuptuar akuzën, konform nenit 248 të KPPK-së të pandehurit iu ofroi mundësin ta pranonë fajsinë ose të deklarohen të pafajshëm.

Nga dëshmia e dëshmitarit [REDACTED] është vërtetuar se ditën kritike [REDACTED] dhe një person tjetër kishin hyrë në lokal dhe [REDACTED] e kishte ka kapur për maice dhe e ka pyetur shokun e tij Imerin se ishte ky ai personi dhe e ka goditur me grusht në kokë.

I akuzuari [REDACTED] në mbrojtjen e tij ne shqyrtimin gjyqësore, ka deklarua se dite kritike së bashku me vëllain e tij [REDACTED] kishin shkuar tek kafiteria [REDACTED] pasi që me parë në telefon i kishte thirrur [REDACTED] shoku i vëllait të tij dhe pasi që [REDACTED] kishte filluar që të fjaloset me vëllain e tij [REDACTED] kishte filluar përleshja si dhe e pranon faktin se edhe ai kishte goditur pasi që ka qenë një përleshje mes të gjithë të pranishmëve

Nga mbrojtja e te pandehurit [REDACTED] vërtetohet fakti se i njëjti ditën kritike pas një mosmarrëveshje në mes të pronarit të kafi terisë [REDACTED] të pandehurit [REDACTED] lidhur me pagesën e pijeve i pandehuri arrin te kafiteria dhe aty fillon kacafytja në mes të gjith të akuzuarve me mjete të forta e godasin të dëmtuarin [REDACTED] më çrrastë shkaktojnë lëndimet e të lehta trupore.pësojnë edhe të akuzuarit .

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se ne veprimet e te akuzuarit [REDACTED] formësohen tiparet objektive dhe subjektive te veprës penale **„lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par. 1 nën par 4 dhe 23 të KPK-së.**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit Gjykata vlerësoi rrethanat ne kuptim te neneit 64 KPK-se si rrethane lehtësuese për te akuzuarit , [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] e kanë pranuar fajsinë për veprën penale për të cilën I ngarkon akuza kanë shprehur pendimin e thellë për veprën të cilën e kanë kryer si dhe faktin se me të dëmtuarit janë pajtuar .I akuzuari [REDACTED] duk e ka pranur fajsinë për veprën penale si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin pati parsyshë moshen e re me faktin se me të dëmturit është pajtuar . Si rrethana renduese Gjykata pati parasysh rrezikshmërinë konkrete te veprës penale ,rrethanat, mënyrën dhe kohen e kryerjes se vepres penale .

Mbi bazën e këtyre rethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj vepre penale duke qenë e bindur se me dënimin e kushtëzuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale.

I Dëmtuari [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.


Obligohen të akuzuarit [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] që secili veq e veq në emër të paushallit gjyqsor të paguaj kësaj gjykate shumën prej 30/tridhjet / Euro, dhe në emër të shpenzimëve të procedurël penale në shumën prej 25 € të gjitha në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmëris së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nga arsyet e cekura më lartë është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ P.nr.1980/12 të dt. 09.11.2015.**

Sëk.juridike

Gentiana Hoxha



**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

**Gj y q t a r j a**

Hysnije Gashi

